



Pranuar / Dorezuar Përmirësim/Prodato Received / Delivery		13 - 01 2023 viti god vegt	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	340/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1071/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-Anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1071/2022 të datës 30.11.2022, të parashtruar nga _____, rr."Agim Ramadani" nr.69 Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë" në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1071/2022 të datës 30.11.2022 të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi _____, Koordinator i gjendjes civile në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 30.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7499/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1071/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përkrahimin e vendit të punës, nga koeficienti aktual shtatë (7.5) në koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarëve



në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.


Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.1071/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

